

VENDIM
Nr. 224 datë 17.4.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE FONDIT PËR ZHVILLIM ABU DHABI, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“NDËRTIMI I BULEVARDIT VERIOR DHE REHABILITIMI I LUMIT TË
TIRANËS”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 150/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi, për financimin e projektit “Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”, të ratifikuar me ligjin nr.150/2013, me qëllim shtyrjen e afatit të disbursimit, sipas marrëveshjes së huas, deri më 30.6.2020, sipas përmbajtjes së dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FONDI PËR ZHVILLIM I ABU DHABIT

Datë: 28.11.2018

Ref: ADFD-DG-1768-2018

Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Lënda: Projekti i rehabilitimit të lumit të Tiranës – “Moskundërshtimi” për zgjatjen e datës së fundit për tërheqje (LDW)

Shkëlqesia juaj,
Fondi për Zhvillim i Abu Dhabi (FZHADH) iu shpreh përshëndetjet më të ngrohta.

Më tej, kjo letër vjen në vijim të shkresës suaj me numër reference 19/4, të datës 17 korrik 2018 në lidhje me kërkesën tuaj për zgjatjen e datës së fundit për Tërheqjet (LDW) për Projektin e Lumit të Tiranës.

Do të donim t’iu informonim se FZHADH-ja nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e datës së fundit për tërheqjet (LDW) për Projektin e lumit të Tiranës deri më 30 qershor 2020.

Ju lutem pranoni përshëndetjet dhe konsideratat tona më të ngrohta.

Me respekt,

Nënshkrimi

Mohammed Saif Al Suwaidi
Drejtore i përgjithshëm